

20140280945

**LIGJ PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKA
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM-BANKA BOTËRORE SIPAS
MARRËVESHJES PËR HUA TË DYTË PROGRAMORE PËR POLITIKA ZHVILLIMORE
PËR KONKURRENCË**

Neni 1

Republika e Maqedonisë merr hua te Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore në shumë prej 36 400 000 euro të dedikuar për realizimin e Huas së dytë programore për politika zhvillimore për konkurrencë.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për Hua të dytë programore për politika zhvillimore për konkurrencë, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar prej tij.

Neni 3

Afati i pagesës së huas nga neni 1 i këtij ligji është 18 vite, me grejs periudhë të përfshirë prej pesë vitesh.

Shkalla e kamatës është EURIBOR gjashtëmujor me shtrirje variabile.

Në ditën e tërheqjes së mjeteve të huas Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore provizion të njëhershëm në shumë prej 0,25% të shumës së huas.

Huaja do të paguhet në 26 këste gjysmëvjetore në çdo 15 mars dhe 15 shtator të vitit. Nga 15 marsi 2019 deri më 15 mars 2031 do të paguhet 25 këste gjysmëvjetore secila në shumë prej 3,85 % të shumës së huas, ndërsa më 15 shtator 2031 do të paguhet kësti i fundit në shumë prej 3,75 % të shumës së huas.

Neni 4

Shfrytëzues i mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji është Ministria e Financave.

Neni 5

Republika e Maqedonisë huan nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.